



RIK E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of KosovoORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Nr./Br.

M/20

Datë/Datum.

02.03.2020

PRISHTINE - PRISTINA



PSH.nr. 11/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Goran Milenković - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “VLERA SH.P.K”-Shtime, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: “Besim A. Zejnullahu B.I.– Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “DDD i institucioneve arsimore” me nr. të prok: 616-19-9412-2-2-5, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Prishtinë, më datën: 04.02.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “VLERA SH.P.K”-Shtime, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “DDD i institucioneve arsimore” me nr. të prok: 616-19-9412-2-2-5, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Prishtinë.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “DDD i institucioneve arsimore” me nr. të prok: 616-19-9412-2-2-5, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Prishtinë dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “VLERA SH.P.K”-Shtime, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues “VLERA SH.P.K”-Shtime, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 06.01.2020 me nr. 11/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “DDD i institucioneve arsimore” me nr. të prok: 616-19-9412-2-2-5, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues - Kuvendi Komunal Prishtinë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 7, 51,59 dhe nenin 61 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 08.01.2020, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 13.01.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim: Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues, nuk ka respektuar nenin 61 të LPP-së, dhe Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët. Eksperti shqyrtues, sqaron se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues se me rastin e vlerësimit të tenderëve (Tenderët Jo-normalisht të Ulët) nga autoriteti kontraktues, është i bazuar sepse në ofertën e operatorit ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës Besim A. Zejnullahu B.I. – Ferizaj, ka të bëjë me çmime Jo normalisht të Ulëta. Autoriteti kontraktues gjatë vlerësimit të tenderëve nuk ka vepruar në pajtueshmëri të plotë me nenin 61 të LPP-së (Tenderët Jo-normalisht të Ulet). AK fare nuk ka kërkuar një shpjegim nga OE i rekomanduar për dhënie (këtë e konfirmon edhe AK në vendimin mbi refuzimin e kërkesë për rishqyrtim të datës 26.12.2019), në pajtueshmëri me Nenin 4 Procedura e shqyrtimit (interpartes), që është dashtë që AK të kërkojë nga operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie, pasi që janë përmbushur të gjitha kushtet në pajtim me nenin 3 par. 3.1 të Rregullat për tenderët Jo-Normalisht të ulët (Tabela:1), po citoj: “Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme: i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm; ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët; iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë.

Tabela

Nr.	Titulli: DDD I institucioneve arsimore - negociuar, dhe nr. Prok.: 616-19-9412-2-2-5			
	A	B	C	D
1	kushti 1 -është përbushur kushti i pare sepse janë pranuar 3 oferta	<i>Pranuar 3</i> <i>oferta Të 3 (tri)</i> <i>ofertat janë të</i> <i>përgjegjshme</i>		
2		1	12379,98	
3		2	17332	
4		3	7427,99	
8		Total (C2+C3+C4)	37139,97	
9		mesatarja (C8/3)	12379,99	
10	kushti 2 - te gjitha ofertat nen ketë çmim përbushin kushtin e dytë	pragu 30% (mesatarja /1.3)	9523,07	në këtë rast vetëm oferta 3 përbush kushtin e dyte prandaj vazhdohet me kushtin e trete
11	kushti 3 – pragu 10% në mes ofertës më të lirë në krahasim me ofertën e dytë më të lirë	pragu 10% (oferta e dytë /1.1)	11254,53	në këtë rast oferta 3 përbush edhe kushtin e tretë

Gjithashtu, Eksperti Shqyrtues sqaron si ne vijim: Është përgjegjësi, dhe ne diskrecion të Autoritetit Kontraktues respektivisht e komisionit te vlerësimit qe gjatë procesit te vlerësimit te tenderuesve, te trajtoj dhe analizoje çmimin, apo te konsiderohet si jo normalisht i ultë në pajtim me nenin 61 të LPP-së. Autoriteti kontraktues gjate vlerësimit te këtij tenderi nuk ka vepruar ne pajtim me dispozitat ligjore, dhe ne këtë rast me nenin 61 te LPP-se, duke mos kërkuar fare nga operatori i rekomanduar për dhënie te kontratës, për te dhënë një shpjegim për çmimet jo normalisht te ulëta, edhe pse shihet nga arsyetimi me lartë se është dashtë një veprim i tille nga autoriteti kontraktues pasi janë plotësuar te tri kushtet sipas, sipas rregullave për tenderët Jo-Normalisht te Ulët. Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësore se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë është i qëndrueshëm.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 7 dhe 59 të LPP-së. Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmime te dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, AK nuk ka vepruar ne harmoni te plote me dispozitat ligjore te LPP-se, konkretisht nenin 7 par. 2 te LPP-se, po citoj: “Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik”, si dhe nenin 59 par. 2 te LPP-se, po citoj: “Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve”. Duke marr për baze përgjigjen ne pretendimin nr. 1 si me larte dhe rrjedhën analizën e këtij aktiviteti te prokurim, Ftesën për ofertim, dosjen e tenderit, pyetjet nga OE/informata shtesë për operatoret ekonomik, si dhe përgjigjet nga autoriteti kontraktues, raportin e komisionin te vlerësimit, vendimin e nxjerr nga Departamenti i Prokurimit – refuzohet kërkesa për rishqyrtim te datës 26.12.2019. Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e autoriteti kontraktues dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këto pika janë të qëndrueshëm.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 51 të LPP-së. Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmime te dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, operatori ekonomik ankues tek deklarata mbi faktet dhe argumentet nuk ka dhënë ndonjë sqarim apo arsyetim se ne çfarë rrethane autoriteti kontraktues ka shkelur dispozitat e nenit 51 të LPP-së, andaj, duke pas parasysh kërkesën e autoriteti kontraktues dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë nuk është i qëndrueshëm. Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë te obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike te përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet te këtë ne konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejt të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet e bazuar, dhe rekomandon të anulohet njoftimi - B58 njoftimit mbi vendimin e AK, (njoftimit për dhënie të kontratës), dhe lënda të kthehet në Ri-vlerësim.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 16.01.2020 , me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë: 13.01.2020, me anë të parashtrësës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 04.02.2020, ku kanë qenë prezent të gjithë anëtarët e panelit shqyrtues, përfaqësuesi i OE-së ankues, përfaqësuesit e AK-së, si dhe eksperti shqyrtues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtrësat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së ankues z. Salihaj deklaroj: përshëndetje për te gjithë, e falënderoj edhe mendimin e Eksperti Shqyrtues këtu janë shkelur disa dispozita por kryesorja është neni 61 tender jonormalisht te ulet, Çmimi i ofertuar nga OE i rekomanduar Besim Zejnullahu është 7.427.99 euro , Çmimi i dyte është 12.379.00 ndërsa çmimi 3 17.332.00 euro. Sipas analizës se bërë na kompania jone del se duhej te konsiderohet si tender jonormalisht i ulet, dhe duhet te jep një arsyeshmëri ekonomike për shkak te çmimit qe ka qenë tepër i ulet. Autoriteti Kontraktues nuk ka kërkuar dhe nuk ka përdorur shkresën standarde për tender jonormalisht te ulet dhe drejtpërdrejt e ka shpërblyer me kontrate edhe sepse ketë gjë do te duhej ta bënte sa për sy e faqe sepse dihej se Autoriteti Kontraktues do ta shpërblente me kontrate edhe nëse nuk e kish arsyetuar çmimin, është shqetësuese për te njëjtin tender qe ka qenë i hapur për te njëjtat metra katror është dhëne çmimi 23.759 euro, ia dorëzoj panelit procesverbalin e hapjes panelit, i njëjti OE me çmimin me te ulet shpallet fitues dhe me çmimin me te lart shpallet fitues, kjo na shtinë me dyshuar se ka lidhje mes Autoriteti Kontraktues dhe OE te rekomanduar. Ne seancën e kaluar e kam par me kamere përfaqësuesi i OE te rekomanduar ka shantazhuar kompaninë tone për falsifikim te dokumentacionit tone, dua një sqarim nga Ak se si ka mundur OE te merr dokumentin Original te ATK-s dhe Gjykatës e këtu te vije te prezantoj. Kjo konsiderohet shkelje e etikes se punës profesionale nga Autoriteti Kontraktues , çka dua te ceku këtu është dashur te kërkohet një arsyeshmëri ekonomike ku tash ka dal 4 fish me lire se ne procedurat tjera.

Anëtari qe ka qenë konsorcium për tenderin me procedurë te hapur ka thënë qe vazhdimisht qe ethe thirrur ne telefon nga OE i rekomanduar duke i bërë presion dhe shantazh qe te largohet nga konsorciumi ynë. OE i rekomanduar është i lidhur direkt me Autoriteti Kontraktues-ne dhe shpërblehet shume here me kontrate , Autoriteti Kontraktues po përdor standarde te dyfishta për disa OE.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesja e i AK-së znj. Sekiraqa deklaroj: Autoriteti Kontraktues nuk pajtohet me mendimin e E>SH qe te anulohet vendimi dhe lënda te kthehet ne rivlerësim. Kjo procedure ka rrjedhe për

shkak te tej zgjatjes se procedurës paraprake, qëllimi ka qenë qe te realizohet sa me shpejt një kontrate që mos të ketë ndonjë epidemi në shkollat e Prishtinës. Konsiderojmë se vlerësimi i kriterit abnormalisht është kompetencë e Autoritetit Kontraktues dhe nuk është bazë për eliminim e aq me pak një procedurë te negociuar qe është dashur te përfundoj sa me shpejte.

Po lidhem me sqarimet qe kërkoj OE i njëjti tender, para masa dallon, konsideroj qe nuk është sasia, pika 2 potencuat qe OE ka ardhë me vërtetime Origjinal, origjinal nuk ka shanse ti jepet askujt. Për vërtetime nuk kemi çka diskutojmë.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti Shqyrtues z. Beqiri deklaroj: I ndëgjova te 2 palët, janë sqaruar detajet, qëndroj mbrapa mendimit të dhënë në ekspertizë.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së z. Salihaj deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues te aprovohet ankesa jone si e bazuar dhe lënda te kthehet ne rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e AK-së znj. Sekiraqa deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues te hedhe poshtë ankesën e OE si te pa bazuar dhe te mbetet ne fuqi vendimi Autoritetit Kontraktues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues "VLERA SH.P.K"-Shtime, se autoriteti kontraktues nuk ka respektuar nenin 61 të LPP-së dhe Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues është i bazuar sepse në ofertën e operatorit ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës Besim A. Zejnullahu B.I. – Ferizaj, kë të bëjë me çmime Jo normalisht të Ulëta. Autoriteti kontraktues gjatë vlerësimit të tenderëve nuk ka vepruar në pajtueshmëri të plotë me nenin 61 të LPP-së (Tenderët Jo-normalisht të Ulet). Për më tepër, AK fare nuk ka kërkuar një shpjegim nga OE i rekomanduar për dhënie të kontratës (këtë e konfirmon edhe AK ne vendimin mbi refuzimin e kërkesë për rishqyrtim te datës 26.12.2019), në pajtueshmëri me Nenin 4 Procedura e shqyrtimit (interpartes), është dashur që AK të kërkoj nga operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie, pasi qe janë përmbushur të gjitha kushtet në pajtim me nenin 3 par. 3.1 të Rregullat për tenderët Jo-Normalisht te

ulet. Paneli Shqyrtues sqaron se eksperti profesional i prokurimit ka dhënë sqarime dhe shpjegime në tabelën 1 të raportit të ekspertizës, ku këto shpjegime gjenden si më lartë.

Gjithashtu, Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se është përgjegjësi dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues, respektivisht e komisionit të vlerësimit që gjatë procesit të vlerësimit të tenderuesve, të trajtoj dhe analizoj çmimin apo të konsiderohet si jo normalisht i ultë në pajtim me nenin 61 të LPP-së. Po ashtu, Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se autoriteti kontraktues gjatë vlerësimit të këtij tenderi nuk ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore, dhe në këtë rast me nenin 61 të LPP-së, duke mos kërkuar fare shpjegim apo sqarim nga operatori i rekomanduar për dhënie të kontratës, për çmimet jo normalisht te ulëta edhe pse shihet nga arsyetimi me lartë se është dashtë një veprim i tillë të merret nga AK pasi janë plotësuar të tri kushtet sipas rregullave për tenderët Jo-Normalisht te Ulët.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues “VLERA SH.P.K”-Shtime se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 7 dhe 59 të LPP-së, Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se AK nuk ka vepruar në harmoni të plotë me dispozitat ligjore të LPP-së, konkretisht nenin 7 par. 2 të LPP-se, në të cilin thuhet: “Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shume operatoreve ekonomik”, si dhe nenin 59 par. 2 të LPP-së, ku thuhet: “Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve”. Duke marr për bazë përgjigjen në pretendimin e parë si më lartë dhe rrjedhën analizën e këtij aktiviteti të prokurimit, Ftesën për ofertim, dosjen e tenderit, pyetjet nga OE/informata shtesë për operatoret ekonomik, si dhe përgjigjet nga autoriteti kontraktues, raportin e komisionin te vlerësimit, vendimin e nxjerr nga Departamenti i Prokurimit – refuzohet kërkesa për rishqyrtim te datës 26.12.2019. Pra, në bazë të këtyre fakteve dhe duke pas parasysh kërkesën e autoriteti kontraktues dhe sqarimeve të ekspertit profesional të prokurimit, Paneli Shqyrtues vlerëson se ky pretendim ankimor është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues “VLERA SH.P.K”-Shtime, se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 51 të LPP-së, Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se operatori ekonomik ankues tek deklarata mbi faktet dhe argumentet nuk ka dhënë ndonjë sqarim apo arsyetim se në çfarë rrethane autoriteti kontraktues ka shkelur dispozitat e nenit 51 të LPP-së. Andaj, ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues nuk e ka zhvilluar procedurën siç parashihet tek Rregullat për Tenderët Jo-normalisht të Ulët dhe konform nenit 61 të LPP-së, prandaj obligohet autoriteti kontraktues që

gjatë rivlerësimit të ofertave të merr parasysh nenin 61 të LPP-së, dhe njëkohësisht ti përmbahet në detaje Rregullores për Tenderët Jo-normalisht të Ulët dhe procedurës inter partes.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së. Gjithashtu, paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
z. Goran Milenković



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK- Ministria e Infrastrukturës
- 1x1 VLERA SH.P.K - Shtime
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.